



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 174 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE
Nr. 2709/7 Prot.

AKT- MARREVESHJE

Lidhur sot më datë 1.7.2004, ndermjet :

Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive, përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj.Fatmira Laska, në bazë të tagrit që i jep Ligji nr. 9049, date 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", që më poshtë do të quhet **ILDKP**.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z.Ardian PETOLLARI, në bazë të tagrit që i jep ligji nr.8569, datë 28.12.1999 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", me adresë Rruga e Elbasanit, që më poshtë do të quhet **DPT**.

Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, lidhin marrëveshjen, si më poshtë;

Neni 1

Objekti i Akt-marrëveshjes

Objekti i kësaj akt-marrëveshje është përcaktimi i proçedurave për realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit lidhur me proçesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj akt-marrëveshje është ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i proçedurave administrative", ligji nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ligji nr.8560, datë 22.12.1999 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e

nënligjore që rregullojnë çështje që parashikohen në dispozitat e kësaj akt-marrëveshje.

Neni 3

Qëllimi i Akt-marrëveshjes

Qëllimi i kësaj akt-marrëveshje është realizimi i shkëmbimit të informacionit, që lidhet me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Neni 4

Detyrime te Inspektoriatit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Për të kryer kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, informacioni i nevojshëm do t'i vihet në dispozicion ILDKP-së, pas kërkesës me shkrim të Inspektorit të Përgjithshëm.

Për të pasur efikasitet në bashkërendimin e punës ndërmjet palëve, kërkesa duhet të jetë e përcaktuar me të dhënat e domosdoshme në mënyrë që informacioni i kërkuar të identifikohet pa vështirësi.

Neni 5

Detyrimet e Drejtorise së Përgjithshme të Tatimeve

DPT-ja, angazhohet të verë në dispozicion çdo informacion apo të dhënë që disponon ajo, në lidhje me kërkesën e detajuar nga ILDKP-ja, i cili ka të bëjë me vetëdeklarimin e subjektit për të cilin kërkohet ky informacion.

DPT-ja, pas protokollimit të kërkesës, brenda 15 ditëve do të verë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP-ja, të dhënat e kërkuara.

DPT-ja, do të autorizojë personin e kontaktit, i cili do të përgjigjet drejtpërdrejt për kërkesën e bërë nga ILDKP-ja.

Neni 6 **Zbatimi i Akt-marrëveshjes**

Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë akt-marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Korrespondenca midis paleve do të bëhet brenda ditës me korier të posaçëm.

Të dy institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj akt-marrëveshje. Zbatimi i saj është i detyrueshëm për palët.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Akt-marrëveshja hartohet në dy kopje, të cilat kanë fuqi ligjore të njëjta dhe shpërndahet si më poshtë:


- Një kopje për ILDKP-në,
- Një kopje për DPT-në.

Kjo akt-marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nëshkrimit të saj nga palët.

**PER INSPEKTORATIN E
LARTE TE DEKLARIMIT DHE
KONTROLLIT TE PASURIVE**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



**PER DREJTORINE
E PERGJITHSHME TE
TATIMEVE**

Drejtori i Përgjithshëm

ARDIAN PETOLLARI